



**Për:** **Z. Endri Hasa**  
Përfaqësues i Autorizuar  
**Z. Gazment Bardhi**  
Sekretar i Pergjithshëm  
Selia e Partise Demokratike, Tiranë.

**Në vëmendje të:** **Z. Lulzim Basha**  
Kryetar i Partise Demokratike  
Klient Vodafone

Nr. CEO/007/Prot.

Tiranë, më 20 Mars 2020

I nderuar Z. Hasa,

Jemi informuar në lidhje me ngjarjen e SMS-së së klientit tonë Z. Lulzim Basha përmes Letrës suaj më 19.03.2020. Vodafone Albania ka ndërmarrë veprime të menjëhershme për të investiguar rastin në fjalë dhe nga analiza e kryer rezulton se:

SMS-ja e marrë në numrin 06xxxx80 në datë 18.03.2020 në orën 23:00:22, është origjinuar nga një platformë e huaj SMS në internet për dërgimin e sms-ve, jashtë rrjetit Vodafone, ku në ID-në e dërguesit është vendosur numri 0682072070 dhe nuk rezulton si SMS e vërtetë e dërguar nga numri 0682072070 i mbajtur nga z.Basha.

Përveç kësaj, nga ekrani i printuar i komunikimeve midis z. Lulzim Basha dhe numrit 06xxxx80, dëshmohej se sms-ja e marrë është në formën e një SMS-je të thjeshtë, ndërkohë që korrespondenca normale midis z. Lulzim Basha dhe numrit 06xxxx80 është në formën e i-mesazhe (i-message).

Duke marrë parasysh sa më sipër, **konkludojmë se SMS-ja nuk është gjeneruar nga numri i klientit tonë Z. Lulzim Basha.**

Vodafone Albania do të donte t'ju siguronte që ne mbrojmë integritetin e rrjetit tonë dhe të dhënat personale të klientëve tanë me masat më të mira të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale në të gjithë botën. Ne mbetemi plotësisht të përkushtuar për të bashkëpunuar me ju dhe autoritetet shtetërore përkatëse gjatë hetimit të çështjes në fjalë.

Me respekt,

Vodafone Albania Sh.A.  
Achilleas Kanaris  
Administrator